

**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**  
(Të gjitha balancat janë në lekë).

**1. Informacione të përgjithshme**

"ELECTRO SECURITY ALBANIA" sh.p.k, është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 03.02.2010. Kapitali i regjistruar është 100 000 leke dhe zotrohet nga ortakët i vetëm Znj. Migena Goga në masën 100%. Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë për ushtrimin 2020 është: Projektim, instalim, programim impiantesh në fushën e ruajtjes elektronike dhe elektrike. Import eksport të pajisjeve, materialeve të ndryshme dhe aksesoret e tyre. Tregti me shumicë e pakice. Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike, pakice.

**2. Përmbledhje e politikave kontabel**

**Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të konstatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

***Pasqyrat financiare janë të hartuara sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit . Si pasojë shifrat e vitit 2020 janë të krahasueshme me ato të vitit 2019, pasi janë zbatuar politika kontabel të njëjta.***

*Ne paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2020 është zbatuar formati i SKK-2 dhe për rrijedhim zërat e pasqyrave financiare të periudhës 2019 janë të krahasueshm.*

**Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:**

**Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tregtarëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabel me të ardhurat e lidhura.

**Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj riveleshën me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk riveleshën. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020 janë 1 euro=123.7 leke edhe 1\$=100.84 leke

**Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për të paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal në të cilat për ushtrimin e mbyllur më 31.12.2020 . Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2020 është 5 % .

**Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogaritë të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi

ELECTRO SECURITY ALBANIA  
T: 04940230 TIRANA  
ALBANIA

është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër). Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2020 nuk janë llogaritur provizione.

### Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme.

### Aktivitet Afatgjata Materiale

Aktivitet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### Gjendjet e inventaret

Vlerësimi në hyrje i inventareve bëhet me çmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjelle inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi i shoqërisë janë çmuar si vlera neto të realizueshme.

### 3. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare në banke dhe arke, në leke dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 janë si më poshtë:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja në 31.12.2020		Gjendja në 31.12.2019	
		Në leke	Në valute	Në leke	Në valute
Llogari bankare	LEK	1,667,428	-	2,336,499	-
Arka në leke	LEK	3,938	-	17,558	-
<b>Shuma</b>		<b>1,671,366</b>	<b>x</b>	<b>2,354,057</b>	<b>x</b>

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhenat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë konvertuar në leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të shpallur nga Banka Shqiperise.

### 4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kërkesat e arketueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2020 deklarohen si vijto

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme (Klient)	2,010,925	2,254,540
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme 444	0	0
(iii) Kërkesa të tjera të arkëtueshme (TVSH)	59,372	58,227
(iv) Të tjera kërkesa (Garanci bankare)	0	0
	0	6,766
<b>Shuma</b>	<b>2,070,297</b>	<b>2,319,533</b>

Në "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme" janë pasqyruar klient për faturat e papaguara për shitje malli që shoqëria ka realizuar gjatë ushtrimit 20 në shumën 2 010 925 leke.

ELECTRO SECURITY ALBANIA  
T: 04040230 TIRANA  
ALBANIA

Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" perfaqesojne tepricen debitore te tartimit mbi fitimin ne shumen 59 372 leke

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe me vleren e tyre nominale dhe

## 5. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
<b>Inventari</b>		
(i) Lëndët e para	-	-
(ii) Prodhim në proces	-	-
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra për rishitje	11,546,818	8,640,691
(v) Parapagesat për furnizime	1,774,492	2,007,845
<b>Shuma</b>	<b>13,321,310</b>	<b>10,648,536</b>

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit te ushtrimit 2020. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e kosos se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares progresive e ponderuar".

Shuma e inventarit te paraqitur ne " Mallra" perfaqson stokun e mallit te blere gjendje me 31.12.2020 destinuar per shitje ne masen 11 546 818 leke , te vleresuara me kostot mesatare te blerjes.Gjithashtu edhe parapagime per furnizim 1 774 492 leke

Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kosos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij


## 6. Aktivt Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe pajsje	Aktivt te tjera afatgjata materiale	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.2020	-	-	3,255,592	300,142	3,555,734
Shtesat	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-
Kosto e AAM-ve 31.12.2020	-	-	3,255,592	300,142	3,555,734
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2020	-	-	566,759	13,004	579,763
Amortizimi ushtrimit	-	-	255,099	11,372	266,471
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2020 *	-	-	821,858	24,376	846,234
C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2020	-	-	-	-	-
Shtesat	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-
9	-	-	-	-	-
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2020	-	-	2,688,833	287,138	2,975,971
Vlera neto e AAM-ve 31.12.2020	-	-	2,433,734	275,766	2,709,500

## 7. Detyrime afatshkurtera-Huamarriet

Huate dhe parapagimet afatshkurtera ne fund te ushtrimit kontabel :



	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Huamarrjet		
(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra	17,676,590	15,859,451
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata	0	0
(iii) Bono të konvertueshme	0	0
Shuma	17,676,590	15,859,451

#### 8. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Huatë dhe parapagimet		
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	0	239,814
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	427,913	348,830
(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore	145,551	117,970
(iv)Te tjera ndaj shtetit (Tvsh)	53,253	401,452
(iii) Detyrimet tatimore TATIMI ne Burim	6,000	6,000
Shuma	632,717	1,114,066

Të pagueshme ndaj furnitorëve nuk ka pasi kemi vetem parapagime per furnizim

"Detyrimet tatimore" perfaqesojne, pagat e punonjesve te dhjetorit 427 913leke ,(Tvsh) 53 253 leke dhe per sigurimet shoqerore e shendetesore te muajit dhjetor 2020 ne shumen 145 551 leke, tatim ne burim (qera) 6 000 leke detyrimet e muajit Dhjetor 2020 te paguara ne Janar 2021.

#### 9. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huate afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 nuk ka :

#### 10. Kapitalet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 03.02.2010 , ai eshte 100 000 leke, i ndare ne 100 kuota me vlere nominale leke .

#### 11. Fitimi (humbja) e vitit financiar

##### ▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Te ardhurat nga shitja e produkteve	0	0
Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve	4,226,760	2,160,672
Te ardhurat nga shitja e mallrave	6,518,905	8,026,364
Te ardhurat te tjera	0	0
Shuma	10,745,665	10,187,036

Të ardhurat nga shitja e sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara , te zhveshura nga TVSH-ja . Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

ELECTRO SECURITY ALBANIA SPT  
T: 04040230 TIRANA  
ALBANIA

▪ **Shpenzimet e veprimtarise kryesore**

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumën e paguar ose të pagueshme. Kostoja e punësimit, pagesa dhe sigurimet shoqërore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar. Taksat lokale e taksat e tatimeve të tjera që lidhen me biznesin janë llogaritur dhe pasqyruar në llogaritë e ushtrimit. Sipas natyrës së tyre shpenzimet e ushtrimit 2020 janë treguar në pasqyrën përkatëse.

▪ **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)	82,994	116
Shpenzimet për interesat 767, 668(-)	-	-
Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)		
Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)	(80,551)	(2,473)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		
Shuma	2,443	(2,357)

▪ **Shpenzime personeli**

Numri mesatar i punonjësve dhe pagat sipas kategorive kryesore janë si më poshtë :

Gjatë vitit 2020 kanë qenë në marrëdhënie pune gjithsej 12 punonjës nga të cilët një administrator dhe të tjerët punëtorë. Pagat gjithsej të paguara janë 5 183 281 leke dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 881 601 leke . Janë bërë rregullisht ndalesat për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

**12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin**

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për ushtrimin kontabel 2019 dhe 2020 janë si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
I FITIMI NETO PËR TATIMIN	145,989	159,901
II SHPENZIME TË PAZBRITESHME (+)		
1 Amortizime të normave fiskale	-	-
2 Shpenzime pritje dhe dhurime të kufirit të tatimit	-	-
3 Gjona, penalitete, dëmshpërblime	2,071	11,020
4 Provizione që nuk njihen	-	-
5 Shpenzime pa dok. ose jo të rregullta	-	-
6 Të tjera-materiale jashtë përdorimit (pa miratim)	-	-
III PJESA E HUMBJES SË MBARTUR(-)	-	-
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMOR (I-II-III)	148,060	170,921
V Shpenzimi i tatimit fitimit 5%	7,403	8,546
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT (I-V)	138,586	151,355

ELECTRO SECURITY ALBANIA SHK  
 TIRANA  
 0230  
 101404

**13. Transaksione te paleve te lidhura**

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , veç huase se marre nga ortaku, e shlyer brenda vitit nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

**14. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit**

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare .

Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2020 ka renie te shifrave te afarizmit dhe fitimi tregetar.

ADMINISTRATORI  
ELECTROSECURITY ALBANIA SHPK  
ALDI DROBONIKU  
PT. L014040230 TIRANA  
ALBANIA